

SHTYPI SHQIPTAR NË EPOKËN E DYTË KUSHTETUESE DHE QËNDRIMI I PORTËS SË LARTË NDAJ TIJ

Gentrit SMAKAJ
Skënderaj

Punim studimor

Përmbajtje e shkurtër: Pas rishpalljes së Monarkisë Kushtetuese, më 23 korrik 1908, zhvillime të rëndësishme ndodhën ndërmjet Perandorisë Osmane dhe shqiptarëve, si dhe në rajone dhe me elementë të tjerë etnikë. Në ditët e para kur u përdorën gjerësisht parimet e lirisë, barazisë dhe vëllazërisë, objektivi kryesor ishte bashkimi i elementeve etnike (*ittihat-ı anasırı*), por disa kërkesa që shkuan përtej qëllimit të tij filluan të tronditnin më shumë ekuilibrin politik dhe social të qendrës dhe krahinave në mënyrë efektive. Dihet se edhe personalitetet osmane me origjinë shqiptare luajtën një rol të rëndësishëm në themelimin e Komitetit Bashkim dhe Përparim dhe në lëvizjen xhonturke. Megjithatë, procesi i bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet shqiptarëve dhe Komitetit të Bashkimit dhe Përparimit mori një formë të ndryshueshme dhe ciklike në varësi të zhvillimeve. Ky proces i shkurtër bashkëpunimi u shfaq në klubet që shqiptarët formuan në kuadrin e të drejtave të tyre kushtetuese, në gazetatat që botonin dhe në shkollat që hapën. Gazetat më të rëndësishme të shqiptarëve në periudhën në fjalë ishin: Bashkimi i Kombit, Zgjidhja e Shqipërisë, Shqiptari, Lirija, Drita, Korça, Tomori, Besa etj. Në këtë studim, “Shtypi Shqiptar në Epokën e Dytë Kushtetuese dhe Qëndrimi i Portës së Lartë Ndaj Tij” u shqyrtua nën dritën e burimeve osmane dhe shqiptare.

Fjalët çelës: shtypi shqiptar, nacionalizmi shqiptar, Porta e Lartë, xhonturqit, Komiteti i Bashkimit dhe Përparimit, Monarkia e Dytë Kushtetuese.

Organet e shtypit në Perandorinë Osmane u krijuan me një vonesë rreth dy shekuj nga Evropa. Gazeta e parë në Perandorinë Osmane ishte *Bulletin de Nouvelles*, e cila u botua jo nga subjektet perandorake, por nga ambasada franceze që në vitin 1795.¹ Deri vonë mendohej se gazeta e parë turke ishte *Takvim-i Vakayi*, e cila u botua në vitin 1831 dhe me këtë gazetë filloi “Historia e shtypit turk”. Megjithatë, studiuesi i njohur turk Orhan Koloğlu vërtetoi se gazeta e parë turke ishte *Vakay-i Misriye*, e cila u botua në Egjipt në 1828, tre vjet përpara *Takvim-i Vakayi*.² Gazetat e botuara në Ballkan zënë një vend të rëndësishëm ndër gazetatat e botuara në botën osmane në shekullin e 19, shekullin më të gjatë të perandorisë siç e quan Profesor İlber Ortaylı.³

Shembujt e parë të shtypit shqiptar mund të ndeshen që në gjysmën e dytë të shekullit XIX. Veç kësaj, gazetatat dhe revistat e botuara nga shqiptarët jashtë vendit siguruan zhvillimin e shtypit shqiptar.⁴ Pas një kohe të shkurtër, gazetatat dhe revistat shqiptare filluan të botoheshin brenda kufijve të Perandorisë Osmane. Megjithatë, intelektualëve shqiptarë iu desh të botonin sërish gazetatat dhe revistat jashtë vendit përballë pushtetit të Sulltan Abdulhamidit II.⁵

Veprimtaritë e shtypit kanë një rëndësi të pamohueshme në zhvillimin e nacionalizmit shqiptar. Ndërsa njëmbëdhjetë revista periodike u botuan midis 1876 dhe 1896, të paktën dyzetegjashhtë gazeta ose revista

¹ Orhan Koloğlu, *Osmanlı'dan 21. Yüzyıla Basın Tarihi*, Pozitiv Yayınları, İstanbul, 2006, 21

² Orhan Koloğlu, *Osmanlı'dan 21. Yüzyıla Basın Tarihi*, 24; Hıfzı Topuz, *II. Mahmut'tan Holdinglere, Türk Basın Tarihi*, Remzi Kitabevi, İstanbul, 2016, 13. Sipas disa studiusve kjo nuk mund të pranohet si gazeta e parë. Sepse kur nisi të dilte kjo gazetë, Egjipti ishte në një pozicion gjysmë të pavarur nga Perandoria Osmane. İsmail Arslan, *Balkan Savaşlarının 100. Yılı Anısına, Elveda Rumeli Merhaba Rumeli*, İstanbul, 2013, 40-41.

³ İlber Ortaylı, *İmparatorluğun En uzun Yüzyılı*, İstanbul, 2001.

⁴ İhsan Burak Birecikli, *Arnavutlar ve Arnavutluk Sorunu 1908-1914*, Gazi Üniversitesi Sosyal Bilimler Enstitüsü, Teza e Doktoratës, Ankara, 2010, 205.

⁵ Bilgin Çelik, *İttihatçılar ve Arnavutlar*, İstanbul, 2004, 231.

të reja u botuan midis 1897 dhe 1908.⁶ Midis viteve 1880-1908 u botuan në shqip 30 gazeta të ndryshme, periodikë dhe shumë libra. Shtatë nga gazetat e botuara gjatë kësaj periudhe u botuan në Bullgari, shtatë në Itali, katër në Egjipt, katër në Rumani, tre në Belgjikë dhe nga një në Austri, Greqi, Amerikë dhe Londër.⁷

Shtypi shqiptar para Monarkisë së Dytë Kushtetuese

Siç dihet gazeta e parë shqiptare u botua në Napoli më 22 shkurt 1848⁸. Emri i gazetës është “L’Albanese D’Italia”.⁹ Kjo gazetë u botua nga Jeronim de Rada. Bashkë me këtë, De Rada botoi revistën me emrin “Fjamuri i Arbërit” në vitet 1883-1887.¹⁰ Numri i parë i kësaj reviste u botua më 20 korrik 1883 dhe vazhdoi deri më 15 nëntor 1887. Revista botohej një herë në muaj dhe kishte 8 faqe.¹¹ “Gazeta Tribuna” e botuar nga shqiptarët që jetonin në Italinë e Jugut, një tjetër gazetë e botuar në Itali “La Speranza Dell Albania”, më 1887 M. Ghuse Skiro botoi në Palermo revistën “Arbëri i ri”. Gazeta e quajtur “Zëri i Shqipërisë” (1879-1882), botuar në Athinë nga Anastas Kullurioti, në gjuhën greke me ndonjë artikull të rastit edhe në gjuhën shqipe. Gazeta “Zëri i Shqipërisë” kishte si qëllim nxitjen e dashurisë për gjuhën shqipe, njëherësh ndjenjën kombëtare. Në fakt tri qëllimet kryesore të kësaj gazete e të veprimtarisë kombëtare të Anastas Kulluriotit në përgjithësi ishin: krijimi i një partie politike shqiptare në Greqi, hapja e shkollave në gjuhën shqipe dhe çlirimi i Shqipërisë nga zgjedha osmane. Kullurioti u përdoq nga Qeveria Greke dhe u akuzua si përhapës i gjuhës shqipe. Për këtë arsye, ai e transferoi gazetën e tij në Bukuresht.¹² Revista “Toska”, e botuar në vitet 1901-1902 në Egjipt dhe revista “Besa” e botuar

⁶ Said Olgun, *XIX. Yüzyılın İkinci Yarısında Arnavut Milliyetçiliğinin Gelişiminde Mehtepeler*, Fırat Üniversitesi Sosyal Bilimler Enstitüsü, Teza e Doktoratës, Elâzığ, 2015, 161.

⁷ Banu İşlet Sönmez, *II. Meşrutiyette Arnavut Muhalefeti*, İstanbul 2007, 59

⁸ Bilgin Çelik, *İttihatçılar ve Arnavutlar*, 232

⁹ BOA. HR.SYS. 118/33.

¹⁰ Robert Elsie, *History of Albanian Literature*, London: I.B.Tauris, 2005, 49.

¹¹ Për këtë shih: Ahmet Kondo, *Fjamuri i Arbërit: Çështja kombëtare*, Tiranë, Naim Frashëri, 1967.

¹² Zihni Reso, *Anastas Kullurioti dhe gazeta “Zëri i Shqipërisë”*, 1879-1880, 8 nëntori, Tiranë, 1981, 125. Po ashtu shih Robert Elsie, *Histori e Lëtërsisë Shqiptare*, Tiranë, 1997, 130.

në vitet 1904-1905, së bashku me revistën “Shqipëria” botuar në Egjipt më 1906¹³ kanë luajtur rol të rëndësishëm në Lëvizjen kombëtare shqiptare.

Dervish Hima botoi gazetën jetëshkurtër “Pavarësia e Shqipërisë”, në Bukuresht, e cila doli më 1898 shqip, frëngjisht dhe rumanisht. Ishte parashikuar që gazeta të dilte një herë në dy muaj. Megjithatë, dritën e panë gjithsej dy numra, i pari në nëntor të 1898-s dhe i dyti më 1899.¹⁴ Në të njëjtin vit në Itali (Romë) Dervish Hima, Ibrahim Temo dhe Mehmet Frashëri arritën të nxirrnin një gazetë me emrin “Zën’ i Shqipënisë”. Numri i parë i kësaj gazete doli me 10 dhjetor 1899. Përbante artikuj në shqip dhe në frëngjisht.¹⁵ Edhe Ibrahim Temo është autor i disa studimeve, i thirrjeve, artikujve publicistikë dhe i dokumenteve programatike, në të cilat spikat racionalizmi i tij në evidentimin e funksionit të veçantë të arsimit dhe të kulturës në zhvillimin e shoqërisë.¹⁶ Dervish Hima botoi një gazetë të quajtur “L’Albanie” në Zvicër (Gjenevë) në vitin 1903¹⁷ dhe vazhdoi të botohej në Bruksel nga viti 1905.¹⁸ Revista “Dituria” botohet në Bukuresht (Rumani) që nga viti 1885. Në vitin 1888, Nikola Naço botoi në Bukuresht një gazetë shqiptare të quajtur “Shqiptari” dhe botimi i saj vazhdoi deri në vitin 1903.¹⁹ Gazeta botohej

¹³ Bilgin Çelik, *İttihatçılar ve Arnavutlar*, 232-233.

¹⁴ Kristaq Prifti, *Dervish Hima (1872-1928)*, Tirane, 1987, 73.

¹⁵ Kristaq Prifti, *Dervish Hima (1872-1928)*, Tirane, 1987, 74-75.

¹⁶ Për jetën dhe veprën e Ibrahim Temos shih: İbrahim Temo, *İttihad ve Terakki Cemiyetinin Teşekkülü ve Hizmeti Vataniye ve İnkılâbı Millîye Dair Hatıratım*, Mecidiye/Romanya 1939.; Kristaq Prifti, *Doktor İbrahim Temo: Jeta dhe Vepra 1865-1945*, Prishtine, 1996; M. Şükrü Hanioglu, “İbrahim Temo (1865-1945) İttihat ve Terakki Cemiyeti kurucularından Osmanlı siyaset adamı”, *Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi*, Cilt 21, 354-355.

¹⁷ Sipas Kristaq Priftit, Dervish Hima në Gjenevë me ndihmën e Ibrahim Temos dhe të bashkatdhetarëve të tjerë, mbledhi materiale mbi lëvizjen shqiptare për gazetën “Albania”, të cilën, pas shumë përpjekjesh, arriti ta nxirrte përsëri. Më 30 tetor të 1902-it i shkruante Temos: “Themelova këtu gazetën, për të cilën të kam folur. Kështu “Albania” jonë do të dalë pas disa ditësh. Shkaku i shtyrjes qëndron në atë që pres lajme nga Shqipëria”. Kristaq Prifti, *Dervish Hima (1872-1928)*, Tirane, 1987, 110.

¹⁸ Dervish Hima ishte kundërshtar i papajtueshëm i sundimit osman në Shqipëri dhe autor i një numri manifestesh radikale që bënë thirrje për luftë të përgjithshme kundër Portës së Lartë. Si i tillë, ai u ndoq këmba-këmbës nga autoritetet osmane kudo që shkonte dhe u burgos disa herë. Për jetën dhe veprën e Dervish Himës shih: Kristaq Prifti, *Dervish Hima (1872-1928)*, Tirane, 1987 si dhe Said Olgun, “Bir Jön Türk ve Arnavut Milliyetçisi: Derviş Hima (1872-1928)”, *Journal of History Studies*, 2018.

¹⁹ BOA. Y.MTV. 35/100.

në tre gjuhë, në gjuhën shqipe, frënge dhe rumune.²⁰ Kjo gazetë vazhdimisht në shkrimët e saj kërkonte rikthimin e kushtetutës së vitit 1876.²¹ Sipas dokumenteve osmane gazeta “Shqiptari” është përdorur si mjet dhe është paguar me para të huaja për të shkaktuar revolta në Shqipëri.²² “*Nuk ka dyshim se këta persona janë të mbajtur me para të huaj për të mos lejuar ngritjen e Shqipërisë. Prandaj, qeveria osmane nuk duhet t'i shkaktojë dëm vendit përmes gazetave të tilla dhe rekomandoi marrjen e masave të nevojshme për këtë qëllim*”.²³

Në vitin 1897 në Bukuresht filloi të botohej një gazetë nga Visar Dodani me emrin “Shqipëria”. Qëllimi i gazetës ishte të ndërgjegjësojë popullin shqiptar se shqiptarët formojnë një komb dhe kanë aftësinë për të vetëqeverisur. Ata kërkuan njohjen zyrtare të kombit shqiptar nga shteti osman dhe mësimin e gjuhës shqipe në shkollat myslimane dhe të krishtera.²⁴

Krahas punimeve për bektashizmin, Naim Frashëri botoi edhe një gazetë të quajtur “Bektashizmi” në Bukuresht më 1896 dhe në Sofje më 1900. Në vitin 1901, në Sofje, gazeta “Drita” filloi të dilte sërish nga Shahin Kolonja dhe vazhdoi të botohej në Sofje deri në vitin 1908.²⁵ Në vitin 1897 në Bruksel filloi të botohej revista “Albania”. Revistën e botoi Faik Konica.²⁶ Revista, e cila kishte botime të ndryshme në Bruksel, Londër dhe Belgjikë, u ndalua të importohet në Perandorinë Osmane më 8 gusht 1898.²⁷

Ndonëse pretendohet se gazeta “Drita”, e cila doli në vitin 1878, ishte gazeta e parë shqiptare, në burime të tjera nuk u gjet asnjë informacion për botimin e gazetës në atë vit.²⁸ Korrespondenti i Gazetës “Drita”, që botohet në Shqipërinë e Veriut, shpreh qëndrimin e pushtetit osman ndaj kulturës dhe arsimit shqiptar në Kosovë me këto fjalë: “*Qeveria ka vënë frenat në këmbë, nuk di të ndalojë. Kërkon nëpër shumë shtëpi, kush ka gazeta, libra, letra e artikuj, i fut në thes dhe i*

²⁰ BOA. HR.SYS. 155/21.

²¹ BOA. HR.SYS. 155/21.

²² BOA. HR.SYS. 155/21.

²³ BOA. HR.SYS. 155/21.

²⁴ Natalie Clayer, *Arnavut Milliyetçiliğinin Kökenleri Avrupa'da Çoğunluğu Müslüman Bir Ulusun Doğuşu*, Çev.: Ali Berktaş, İstanbul, 2013, 168.

²⁵ BOA. MTZ (04) 119/54; BOA. TFR.I.KV. 196/19595.

²⁶ BOA. Y.A.HUS. 391/46.

²⁷ Said Olgun, XIX. *Yüzyılın İkinci Yarısında Arnavut Milliyetçiliğinin Gelişiminde Mektepler*, 162.

²⁸ Bilgin Çelik, *İttihatçılar ve Arnavutlar*, 234.

*dërgon në qeveri. Mjerë ai që ka librat për Skënderbeun! Shqipëria u la prapa për shkak të punës së padrejtë dhe djegies së librave nga të cilët mësuuan shqiptarët, Shqiptarë të gjorë”.*²⁹

Në vitin 1884, Naim Frashëri filloi të botonte në Stamboll një revistë shqipe të quajtur “Drita” dhe në numrin e tretë të saj u ndryshua emri në “Dituria”. Megjithatë, botimi i revistës u ndalua nga qeveria osmane menjëherë pas kësaj, dhe për këtë arsye revista filloi të botohej në Bukuresht në 1885.³⁰ Një gazetë e botuar në Itali është “La Speranza Dell Albania”. Në një dokument zyrtar thuhet se gazeta, së cilës iu pezullua botimi përkohësisht, ka filluar të shfaqet sërish.³¹ Gazeta botohej nga Nikollë Ivanaj në Raguzë. Emri i plotë i gazetës është dhënë si “Shpnesa e Shcypenis (La Speranza Dell’ Albania)”.³² Numri i parë u botua më 1 korrik 1906. Në artikullin e titulluar Kongreset shqiptare në këtë numër të parë, lajmërohej se së shpejti në Shqipëri do të mblihdeshin shumë kongrese kombëtare dhe në këto kongrese do të merreshin vendime të rëndësishme lidhur me ekzistencën kombëtare shqiptare dhe të ardhmen e trojeve shqiptare.³³ Jashar S. Erebara, në qershor të vitit 1902, filloi të botonte gazetën e vet “Albanija” në Beograd, e cila doli deri më 1906.³⁴ Motoja e këtij organi ishte “Shkipnija e Shkiptarvet”.

Një tjetër gazetë e këtyre viteve ishte “Daşamiri”, që nisi të publikohej më 14 nëntor të vitit 1907, në Trieste dhe më pas doli me titullin “Daşamiri i ri” nga 06.5.1908 e deri më 6.8.1908. “Daşamiri” drejtohej dhe përgatitej nga Mati Logoreci, Ndre Mjeda, Nikollë Ivanaj dhe Zef Curani. Përfaqësues i redaksisë së gazetës ishte edhe Lazër Mjeda. “Daşamiri” ishte gazetë përdyjavshme politike, shoqërore, kulturore dhe letrare. Themeluesit e saj ishin anëtarët e Shoqërisë “Agimi”. Gazeta “Daşamiri” kishte për qëllim zhvillimin kombëtar të shqiptarëve, nën Perandorinë Osmane, si dhe zgjimin e interesit për gjuhën dhe

²⁹ Mucize Ünlü, *Kosova Vilayeti (1877-1912)*, Ankara, 2014, 164.

³⁰ Bilgin Çelik, *İttihatçılar ve Arnavutlar*, 234.

³¹ BOA. HR.SYS. 118/33.

³² BOA. Y.A.HUS. 505/43.

³³ Bilgin Çelik, *İttihatçılar ve Arnavutlar*, 331; İhsan Burak Birecikli, *Arnavutluk ve Arnavutlar Sorunu*, 207.

³⁴ BOA. DH.MKT. 553/11.

letërsinë, si dhe zhvillimin e kulturës shqiptare. Gjithashtu gazeta propagandonte dhe për një alfabet të përbashkët.³⁵

Në një dokument osman thuhet së në vitin 1908 u rekomandua që një shqiptari me emrin Mihal Shan Tepelena t'i lejohej të botonte një gazetë shqipe të quajtur "Bashkimi" (İttihad).³⁶

Nuk mund të thuhet se janë marrë masa të ashpra nga qeveritë osmane ndaj shtypit shqiptar deri në fund të shekullit të 19 dhe në fillim të shekullit të 20-ë. Megjithatë, pas vitit 1897, kontrollet u shtuan kundër shtypjes dhe shpërndarjes së shtypit të botuar nga Shoqëria Biblike dhe nga Katolikët në Shqipërinë e Veriut; filloi të ndalohej hyrja dhe shpërndarja e librave, gazetave dhe revistave të botuara jashtë vendit.³⁷

Më 7 korrik 1906, një ferman sulltani iu dërgua nga kryesekretari departamentit zyrtar për çështjet doganore për të mbledhur librat dhe traktatet në gjuhën shqipe, duke e përshkruar shtypjen dhe shpërndarjen e librave dhe traktateve si në dëm të shtetit. Megjithatë, në janar të vitit 1908, një tjetër vendim për lejimin e hyrjes në vend të librave që kanë licencën zyrtare për shtypje dhe botim iu njoftua Departamentit zyrtar për çështjet doganore nga Ministria e Arsimit.³⁸ Me një vendim të marrë, më 29 janar 1908, *Meclis-i Vükela** ndaloi rreptësisht kalimin në doganë dhe shitjen e librave sektarë të shkruar në shqip me shkronja shqipe, me arsyetimin se nuk njiheshin nga shteti.³⁹ Kjo praktikë që synonte të parandalojë hyrjen në vend të librave të botuar në gjuhën shqipe është zbatuar edhe për revista periodike, si dhe janë marrë disa vendime për ndalimin e gazetave dhe revistave që cilësohen si të dëmshme, ose për të penguar hyrjen e tyre në vend.⁴⁰

Në revistat dhe gazetat e botuara para vitit 1908 kishte botime kundër absolutizmit të Sulltan Abdylhamitit të dytë, si dhe opinione për gjuhën shqipe, historinë dhe problemet kryesore të Shqipërisë. Gjith-

³⁵ Shpend Avdiu, *Gazeta "Daşamiri"- "Daşamiri i Ri" 1907-1908*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2021, 11.

³⁶ BOA. ZB. 24/95.

³⁷ Said Olgun, *XIX. Yüzyılın İkinci Yarısında Arnavut Milliyetçiliğinin Gelişiminde Mektepler*, 161-162.

³⁸ Said Olgun, *XIX. Yüzyılın İkinci Yarısında Arnavut Milliyetçiliğinin Gelişiminde Mektepler*, 162.

* Këshilli i Ministrave

³⁹ Said Olgun, *XIX. Yüzyılın İkinci Yarısında Arnavut Milliyetçiliğinin Gelişiminde Mektepler*, 162.

⁴⁰ Said Olgun, *XIX. Yüzyılın İkinci Yarısında Arnavut Milliyetçiliğinin Gelişiminde Mektepler*, 162.

ashtu, u dhanë informacione për veprimtaritë e ndryshme të intelektualëve shqiptarë, kongrese, mbledhje, konferenca dhe përpjekjet për krijimin e një shoqërie.⁴¹

Shtypi shqiptar në epokën e dytë kushtetuese (1908-1912)

Rishpallja e Monarkisë Kushtetuese, më 23 korrik 1908, ishte një sukses i papritur për Komitetin e Bashkimit dhe Përparimit.⁴² Në të triumfuarit e Kushtetutës së dytë, respektivisht në fitoren e revolucionit të xhonturqve të vitit 1908, një ndër faktorët vendimtarë qe roli i shqiptarëve.⁴³ Pa fuqinë e madhe të shqiptarëve një aksion i tillë nuk mund të kryhej me sukses. E përfaqësuesit e lëvizjes kombëtare shqiptare, duke shpresuar se në regjimin konstitucional të Perandorisë Osmane do t'i realizonin aspiratat e tyre të kahershme, në fitimin e autonomisë, e dhanë kontributin e tyre të denjë.⁴⁴ Në fakt, shqiptarët intelektualë e marrin me plot seriozitet dhe sinqeritet revolucionin, duke kujtuar se me zhdukjen e despotizmit hamidian, do të zhdukeshin të gjitha të këqijat dhe se xhonturqit do t'i mbanin premtimet e tyre që arrinin deri në dhënien e autonomisë.⁴⁵ Në këtë mënyrë Shpallja e Monarkisë së Dytë Kushtetuese dhe administrimi i mëvonshëm i Bashkimit dhe Përparimit ishte një pikë kthese që solli me vete zhvillime jashtëzakonisht të rëndësishme si në aspektin administrativ, politik, social, kulturor e ekonomik të Perandorisë Osmane dhe në historinë e shqiptarëve.

Studiuesi turk Uygur Kocabaşoğlu është shprehur së “Termi i përdorur zakonisht “Monarkia e Dytë Kushtetuese” në të vërtetë nënkuptonte “liri” për disa njerëz”.⁴⁶ Një deklaratë zyrtare me katër rreshta e botuar në gazetën e Stambollit më 24 korrik 1908, njoftonte se

⁴¹ İhsan Burak Birecikli, *Arnavutlar ve Arnavutluk Sorunu*, 205.

⁴² Feroz Ahmad, *İttihat ve Terakki 1908-1914*, İstanbul, 2016, 39.

⁴³ Skënder Rizaj, “Roli i Shqiptarëve në Revolucionin Xhonturk të vitit 1908”, *Kosova, Enti i Historisë së Kosovës, Prishtinë*, 1974, 178; Kristaq Prifti, “Kontributi i Shqiptarëve në Lëvizjen e Turqve të Rinj (1889-1908)” Në: *Gjurmime Albanologjike Seria E shkencave Historike 31-32*, 2001-2002, Prishtinë. 2003, 229-230.

⁴⁴ Skënder Rizaj, “Roli i Shqiptarëve në Revolucionin Xhonturk të vitit 1908”, *Kosova, Enti i Historisë së Kosovës, Prishtinë*, 1974, 178.

⁴⁵ Hasan Kaleshi, *Disa aspekte të luftës për alfabetin shqip në Stamboll*, Në: *Gjurmime Albanologjike*, 1, Prishtinë, 1969, 81.

⁴⁶ Uygur Kocabaşoğlu “*Hürriyet*”i *Beklerken, İkinci Meşrutiyet Basını*, İstanbul, 2010, 35.

Monarkia Kushtetuese ishte rishpallur dhe se zgjedhjet do të mbaheshin sipas Kushtetutës së vitit 1876. Gazetarët u mbledhën në kopshtin e një restoranti. Gazetarët vendosën menjëherë të krijojnë një shoqatë mes tyre. Në atë mbledhje u hodhën themelet e kësaj shoqate të quajtur “Shoqëria Osmane e Shtypit”. Kur Monarkia e Dytë Kushtetuese, e cila u shpall më 23 korrik 1908, hoqi censurën mbi shtypin, vetëm në Stamboll filluan të botoheshin 353 gazeta dhe revista.⁴⁷ Ndërsa ky numër u rrit dhe në tre vitet e para të Monarkisë së Dytë Kushtetuese, u botuan 607 gazeta dhe revista.⁴⁸

Me shpalljen e Monarkisë së Dytë Kushtetuese, në botën e shtypshkronjës pati një ringjallje dhe disa organe shtypi hyn në marrëdhënie të ngushta me shoqatat shqiptare dhe siguruan përhapjen e ideve nacionaliste. Sipas Peter Bartl, “*Pas shpalljes së Monarkisë së Dytë Kushtetuese, gazetat dhe revistat shqiptare po rriteshin si kërpudha*”.⁴⁹ Me iniciativën e shoqërive shqiptare midis viteve 1908-1912, në Turqi dhe jashtë saj u botuan rreth 35 gazeta shqiptare.⁵⁰ Këto gazeta deklarorin se do të bënin gazetari për zhvillimin e kulturës kombëtare në kuadrin e të drejtave dhe kufijve të përcaktuar në kushtetutë.⁵¹

Në mes viteve 1908-1912, gazetat që pasqyronin problemet dhe ngjarjet e rëndësishme të lëvizjes kombëtare për publikun luajtën një rol të rëndësishëm në publikimin e mendimeve të tyre kombëtare dhe mbrojtjen e programit politik të kësaj lëvizjeje.⁵²

Në vitin 1908 filloi të botohej gazeta “Besa” në Stamboll nën drejtimin e Mehmet Frashërit.⁵³ Gazeta botohej në dy gjuhë, shqip dhe osmanisht.⁵⁴ Në nr. 1 të gazetës “Besa” të Stambollit, botuar më “5 vjesht e tretë 1908”, në artikullin “Dhe dy fjalë në vënd të programit”, thuhet se gazeta do të ketë për qëllim “*të përhapurit dhe të mësuarit e gjuhës shqipe, për t’i përpjekur që sa më shumë të fortësohet konstitucioni dhe*

⁴⁷ Hıfzı Topuz, *II. Mahmut'tan Holdinglere, Türk Basın Tarihi*, 82.

⁴⁸ Orhan Koloğlu, *1908 Basın Patlaması*, İstanbul, 2005, 154.

⁴⁹ Peter Bartl, *Millî Bağımsızlık Hareketleri Esnasında Arnavutluk Müslümanları 1878-1912*, çev: Ali Taner, İstanbul, 1998, 277.

⁵⁰ Me të rëndësishmet ishin: “Bashkimi i Kombit”, “Zgjimi i Shqipërisë”, “Shqiptari”, “Lirija”, “Drita”, “Diturija”, “Korça”, “Tomori”, “Besa”, “Bashkimi”, “Dielli”, “Shqypëja e Shqypënis” etj.

⁵¹ İhsan Burak Birecikli, *Arnavutlar ve Arnavutluk Sorunu*, 205-206.

⁵² İhsan Burak Birecikli, *Arnavutlar ve Arnavutluk Sorunu*, 206.

⁵³ Hamit Boriçi, *Gazetarë dhe Publicistë Shqiptarë*, Fjalor Enciklopedik, Botime UGPV, Shkodër, 2005, 131.

⁵⁴ *Besa*, 5 Vjesht e tretë 1908, İstanbul .

të mbahetë kjo udhë që ka zënë tani qeveria që të muntninë dhe Shqiptarët duke përhapurë mësimin e gjuhësisë të mbanjën anën e tyre në udhë të qytetërisë dhe të përparimit... Bujarë, bejler' e parësija duhet gjithënjë ndër mend të ketë e të përkujdeset duke këshilluarë vogëlinë, dhe kshtu të udhëtojmë në këtë udhë të re që na çel dhe e cila quhet e lirisë e e Konstitucionit".⁵⁵

Një vit më vonë Dervish Hima botoi gazetën e quajtur "Shqiptari" (Arnavut) në Stamboll. Numri i parë i saj doli me 31 dhjetor të vitit 1909.⁵⁶ Gazeta e lartpërmendur dilte një herë në javë në dy gjuhë në shqip dhe osmanisht.⁵⁷ Gazeta "Shqiptari" ndërmori një iniciativë në vitin 1910 dhe filloi një fushatë të ndihmave për hapjen e shkollave fillore kombëtare në trojet shqiptare. Shkollat që do të hapeshin do të ofronin arsim në gjuhën shqipe dhe në turqisht.⁵⁸ Megjithatë, gazeta "Shqiptari" nuk u kufizua me kërkesat kulturore-kombëtare. Dervish Hima e ktheu shumë shpejt gazetën e tij në një organ luftarak, i cili në periudhat më të ashpra, të luftës së popullit shqiptar kundër regjimit xhonturk, mbrojti kryengritësit dhe kërkesat e tyre politike për autonominë e Shqipërisë. Kjo është arsyeja që kjo gazetë u mbyll dy herë, kurse drejtori i saj u sulmua pareshtur nga reaksioni xhonturk.⁵⁹

Një tjetër gazetë e botuar në Stamboll ishte "Bashkimi". Gazeta botohej në shqip-turqisht. E drejtuar nga Mihal Shan Tepelena, gazeta botohej vetëm një herë në javë. Ajo u shkri me gazetën "Besa", më 14 janar 1909 dhe u botua me emrin "Besa-Bashkim".⁶⁰

Revista "Diturija" filloi të botohej në Selanik në vitin 1909 nën drejtimin e Mithat Frashërit.⁶¹ Mithat Frashëri kishte filluar të botonte një gazetë me emrin "Lirija" në Selanik një vit me parë (1908). Peter

⁵⁵ Hasan Kaleshi, "Disa aspekte të luftës për alfabetin shqip në Stamboll", Në: *Gjurmime Albanologjike*, 1, Prishtinë, 1969, 81.

⁵⁶ Arnavut (Shqiptari), E Enjte 31 Shenendre 1909, İstanbul.

⁵⁷ Kristaq Prifti, *Dervish Hima (1872-1928)*, Tirane, 1987, 192.

⁵⁸ *Arnavud*, Nr: 22, 23 Haziran 1910; *Arnavud*, Nr: 23, 6 Temmuz 1910.

⁵⁹ Kristaq Prifti, *Dervish Hima (1872-1928)*, Tirane, 1987, 193-194.

⁶⁰ *Başkimi*, 30 Tetor dhe 4 Nëntor 1910; Said Olgun, *XIX. Yüzyılın İkinci Yarısında Arnavut Milliyetçiliğinin Gelişiminde Mektepler*, 164; Bilgin Çelik, *İttihatçılar ve Arnavutlar*, 235.

⁶¹ Bilgin Çelik, *İttihatçılar ve Arnavutlar*, s. 235.

Bartl shkruan se kjo gazetë është tërësisht në gjuhën turke.⁶² Por sipas burimeve të tjera “Lirija” ishte një gazetë shqiptaro-turke.⁶³

Gazeta “Bashkim i Kombit”, botuar nga Fehim Zavalani në Manastir në vitin 1909, është gjithashtu një gazetë shumë e rëndësishme shqiptare.⁶⁴ Kjo gazetë, si disa gazeta të tjera shqiptare, botohej si në shqip me shkronja latine ashtu edhe në turqishten osmane me shkronja arabe.⁶⁵ Në pjesën e sipërme të gazetës tërheq vëmendjen thënia “*Është një gazetë e përjavshme që i shërben Bashkimit dhe Përparimit të Shqiptarëve Osmanë dhe mirëqenies së përgjithshme të atdheut*”.⁶⁶

Gazeta “Drita” është botuar në Sofje nën drejtimin e Shahin Kolonjës. Ishte gazetë e përdyjavshme politike, shoqërore, kulturore e letrare. Numri i parë doli më 1 nëntor 1901 dhe vijoi deri në numrin 101. U ndërpre në vitin 1908.⁶⁷ Drita, e shtypur në gjuhën shqipe me ndonjë artikull të rastit greqisht, turqisht apo frëngjisht, luajti rol në zgjimin e identitetit kombëtar ndër shqiptarët. Në këtë gazetë Sami Frashëri ribotoi manifestin e tij politik “Shqipëria, ç’ka qënë, ç’është e ç’do të bëhet?” e po aty Kolonja e përktheu atë në turqisht dhe e botoi me titullin Arnavutluk: Neydi, Nedir, Ne Olacak?⁶⁸

Më 1911 gazeta me të njejtin emër “Drita” u botua nga Mustafa Hilmi Leskoviku në Manastir.⁶⁹ Drejtor i gazetës “Drita”, e cila u botua me shkronja latine nga shtypshkronja Bashkim në Manastir, emërohet Fehim Zavalani nga Manastiri. Ndërsa Nikollë Ivanaj botoi një gazetë të quajtur “Bashkimi i Drejt” në Shkodër në vitin 1910. Një nga revistat periodike të botuara në Shkodër ishte “Dielli”, që nisi të botohej në vitin 1910.⁷⁰ Në Korçë, në vitin 1908 doli nga Sami Pojani një gazetë e quajtur “Korça”.⁷¹ Kjo gazetë në numrin e saj të datës 26 shkurt 1910

⁶² Peter Bartl, *Milli Bağımsızlık Hareketleri*, 277.

⁶³ Bilgin Çelik, *İttihatçılar ve Arnavutlar*, 235. Si anëtar i Komitetit të Bashkimit dhe Përparimit, Mithat Frashëri, i cili shkroi artikuj në mbështetje të shoqërisë, kritikoi veçanërisht qëndrimin parakushtetues të Ismail Qemalit dhe fjalimet e tij që lavdëronin vëllazërinë greko-shqiptare.

⁶⁴ BOA. BEO. 3802/285098.

⁶⁵ *Bashkimi i Kombit*, 17 Shtator 1910.

⁶⁶ *Bashkimi i Kombit*, 17 Shtator 1910.

⁶⁷ Robert Elsie, *Histori e Lëtërsisë Shqiptare*, Tiranë, 1997, 157.

⁶⁸ AQSH. F. 65. D. 69.

⁶⁹ Hamit Boriçi, *Gazetarë dhe Publicistë Shqiptarë*, 255.

⁷⁰ Bilgin Çelik, *İttihatçılar ve Arnavutlar*, s. 235-236.

⁷¹ MF. MKT. 1149/65.

botonte një foto me *nxënësit shqiptarë qe ishin debuar nga Idadia e Korçës, se donin të mësonin gjuhën e vet me shkronjat e saja*.⁷²

Në vitin 1909, Josif Jovan Bageri nxirrte gazetën e vet të përdyjavshme “Shqypéja e Shqypënis”.⁷³ “Shqypéja e Shqypënis” ishte një revistë e vogël por e bujshme, e cila nisi të botohej në Sofje, më 15 maj 1909 dhe vazhdoi më vonë me një ndryshim të vogël në emër – “Shqiponja e Shqipënis”. Aty botoheshin lajme dhe shkrime të redaksisë shqip e bullgarisht për çështje të ditës, si dhe mjaft poezi me përmbajtje shoqërore e politike. Me gjithë përpjekjet e tij, “Shqiponja e Shqipënis” falimentoi dhe nuk shkoi më përtej muajit prill 1911.⁷⁴

Në Elbasan botohej gazeta “Tomori” nën drejtimin e patriotit e atdhetarit të madh shqiptar Lef Nosit.⁷⁵ “Tomorri” ishte gazetë e përkohshme politike e letrare, që nisi të botohej më 10 mars të vitit 1910 në Elbasan. Ishte gazetë letrare dhjetëditore, me katër faqe, në gjuhën shqipe e sipas alfabetit të Manastirit.⁷⁶ Lef Nosi ndiqej penalisht nga autoritetet osmane për arsye së botonte artikuj që nxiste popullin shqiptar në revoltë kundër Komitetit të Bashkimit dhe Përparimit.⁷⁷

Gazeta në gjuhën shqipe botoheshin edhe në Egjipt. Këto gazeta kishin për qëllim që të nxisnin shqiptarët të rebeloheshin dhe të krijonin shtetin e tyre kombëtar. Gazetat “Rrufeja” dhe “Shkopi” që botoheshin në gjuhën shqipe në Egjipt iu ndalua hyrja në Perandorinë Osmane me arsyetimin se po botonin shkrime kundër Portës së Lartë.⁷⁸ Nga dokumentet osmane kuptohet se, pasi gazetës “Rrufeja” iu ndalua hyrja në Perandorinë Osmane, ajo u ndalua sërish kur u ribotua me emrin “Vetëtima”.⁷⁹ Ndërsa në Kajro gazeta shqiptare “Rrufeja” u ndalua të qarkulloste në tokat osmane dhe u ndoq penalisht për shkak të tendencave nacionaliste.⁸⁰

Si rezultat i rregullimeve të vendosura nga ligji për shtypin, gazetatat në Shqipëri u mbyllën dhe autorët e gazetave u arrestuan. Fehim Zavalani, redaktori i gazetës “Bashkimi i Kombit” në Manastir, u arrestua

⁷² MF. MKT. 1149/65. *Korça*, Korçë 26 Shkurt 1910.

⁷³ BOA. HR.SYS. 119/14.

⁷⁴ Robert Elsie, *Histori e Lëtërsisë Shqiptare*, Tiranë, 1997, 158.

⁷⁵ BOA. DH.SYS. 59/9.

⁷⁶ Hamit Boriçi, *Gazetarë dhe Publicistë Shqiptarë*, 313.

⁷⁷ BOA. BEO. 3806/285382; BOA. I.HB. 59/13.

⁷⁸ BOA. DH.EUM.THR. 34/15 ; BOA. MV. 140/15.

⁷⁹ BOA. MV. 151/39; BOA. DH.EUM.KADL. 16/31.

⁸⁰ BOA. MV. 138/32.

në shtator të vitit 1910 për botimin e një artikulli që tregonte veprimet e ushtrisë osmane në Shqipërinë e Veriut dhe u dënua me burgim e me gjobë prej pesëdhjetë lirash. Artikulli që çoi në gjykimin e tij titullohet “Revolucionet e Kosovës”.⁸¹

Me mendimin se artikulli është kundër politikës së ndjekur nga Komiteti i Bashkimit dhe Përparimit*, u vendos që të zbatohet Ligji i Shtypit. Artikulli tregon keqmenaxhimin e zyrtarëve si shkaktarë të kryengritjes shqiptare në 1910. Ai thekson se Niyazi Beu u ka dhënë garanci shqiptarëve se do të mbronin të drejtat e tyre dhe do të shkolloheshin në gjuhën e tyre, por premtimet nuk u mbajtën. Pas kërkesave të tij personale dhe djalit të tij Asim Beut, Fehim Zavalani u fal përfundimisht me vullnetin e sulltanit më 4 tetor 1910.⁸²

Gazetës shqiptare “Dielli”, që botohej në Boston të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i ndalua hyrja në vend me arsyetimin se bonte shkrime kundër qeverisë osmane.⁸³ Edhe gazetës “Flamuri”, e cila botohej në gjuhën shqipe në Amerikë, i ishte ndaluar hyrja në Perandorinë Osmane.⁸⁴

Reşad Halil Beu kërkoi leje për të botuar një gazetë të quajtur “Vertet” (Hakikat) në shqip dhe osmanisht në Izmir. Thuhet se Mustafa Saffet botoi gazetën “Bashkim” dhe “Hukuk-u Ibad”. Një gazetë me emrin “Zgjimi i Shqipërisë” u botua në Janinë në vitet 1909-1911. Në vitin 1909, “İntibah” filloi të botohej në turqisht me shkronja arabe në Janinë dhe në pranverën e vitit 1911, nga të rinjtë e Janinës filloi një revistë letrare e quajtur “Zülat-ı İrfan”.

Gazeta “Yürek”, drejtor përgjegjës i së cilës ishte deputeti i Elbasanit Haxhi Ali Beu, filloi të botohej më 18 dhjetor 1911 si botim i

⁸¹ BOA. DH.SYS. 68/1; BOA. DH.MUË. D. 68/1; BOA, BEO. 3786/ 283908; BOA. BEO. 3802/285098; BOA. BEO. 3815/286098.

* Në fakt është menduar se artikulli ishte kundër “İttihād-ı Anasır”, një politikë e ndjekur nga Komiteti i Bashkimit dhe Përparimit. Qëllimi i idesë së İttihād-ı Anasır ishte të bashkonte të gjithë ata popuj që jetonin brenda kufijve të Perandorisë Osmane nën një supremaci të përbashkët “osmane”. Kështu, ndërsa qytetarët do të përdornin nën-identitetin e tyre në zona private, të gjithë në hapësirat publike do të konsideroheshin vetëm si osmanë.

⁸² BOA. BEO, 3786/283908; BOA, BEO, 3802/285098; BOA, BEO, 3815/286098.

⁸³ BOA. MV. 136/3; BOA. HR.SYS. 67/45; Gazeta “Dielli”, Boston Mas., April 29, 1910).

⁸⁴ BOA. HR.HMŞ.İŞO. 234/4.

İttihâd-ı Osmanî Arnavud Maârif Mahfilit. Gazeta botohej në gjuhën turke dhe në gjuhën shqipe me alfabetin arab.⁸⁵

Jashar S. Erebara, në gusht të vitit 1911, nisi të botonte një gazetë tjetër të quajtur “Shkupi”, në Shkup për të mbrojtur interesat e kombit shqiptar.⁸⁶

Hapja e shumë klubeve në Shqipëri, botimi i dhjetëra gazetave shqipe, hapja e një shkolle mësuesie në Elbasan për mësimin e shqipes dhe pranimi i shkronjave latine po shqetësonin Portën e Lartë dhe në veçanti Komitetin e Bashkimit dhe Përparimit. Kështu që me urdhër të qeverisë osmane u mbyllën shumë gazeta dhe shoqëri të shqiptarëve.⁸⁷

Politikat centraliste dhe osmaniste që do të përvetësoheshin nga administrata e Bashkimit dhe Përparimit që në vitin 1909 dominuan në marrëdhëniet mes palëve dhe filluan të ndodhnin një sërë konfliktesh midis xhonturqve dhe shqiptarëve. Edhe pse pretendohet se këto konflikte ishin efektive në zhvillimin e lëvizjes nacionaliste shqiptare nga një linjë autonomiste në atë separatiste⁸⁸, burime të ndryshme kanë sjellë interpretime të reja në rendin e ditës. Me shumë të drejtë, prof. dr. Emine Arifi - Bakalli në librin “Përballje historiografike” është shprehur se “*veçimin nga Perandoria Osmane, shqiptarët u munduan dhe madje insistuan që ta arrijnë përmes rrugës evolutive-paqësore, graduale: së pari autonomi e pastaj pavarësi. Për këtë arsye, elita politike shqiptare me përkushtim u involvua dhe kontribuoi në transformimet politike të Perandorisë Osmane duke besuar dhe insistuar për një kohë të gjatë, që çështja kombëtare e tyre të gjente zgjidhje në suaza legjitime-kushtetuese osmane. Por, politika e vendosur e shtypjes, e mohimit dhe thellësisht antishqiptare që ndoqi regjimi xhonturk (1908-1912), si dhe rreziku nga jashtë, bëri që kjo elitë të lëvizte drejt organizimit të një lëvizje të armatosur për Autonominë e Shqipërisë. Pra, të lëviste drejtë një vepërimi radikal për një cak imediat politik por jo dhe përfundimtar*”.⁸⁹

Duhet theksuar se politikat shtypëse dhe të centralizuara të xhonturqve sigurisht që nuk kufizoheshin vetëm në nënshtetasit e krishterë të

⁸⁵ Said Olgun, *XIX. Yüzyılın İkinci Yarısında Arnavut Milliyetçiliğinin Gelişiminde Mektepler*, 169.

⁸⁶ Robert Elsie, *Histori e Lëtërsisë Shqiptare*, Tiranë, 1997, 156.

⁸⁷ BOA. HR.SYS. 137/6.

⁸⁸ Në lidhje me këtë shih: Banu İşlet Sönmez, *II. Meşrutiyette Arnavut Muhalefeti*, İstanbul 2007.

⁸⁹ Emine Arifi-Bakalli, *Përballje Historiografike*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2015, 24-26.

Perandorisë. Si në Rumeli ashtu edhe në Anadoll ata ndoqën politikën e turqizimit dhe u përpoqën t'ua impononin gjuhën turke arabëve, shqiptarëve dhe myslimanëve të tjerë joturq. Në fakt, politika turko-nacionaliste e Bashkimit dhe Përparimit ishte në kundërshtim me politikën osmane të Tanzimatit. Edhe popujt myslimanë, arabët dhe shqiptarët, donin të largoheshin nga perandoria. Sulltan Abdulhamiti u rrëzua nga fronti, pas një periudhe të shkurtër administrimi parlamentar, erdhi diktatura e burokracisë ushtarake.⁹⁰ Xhonturqit donin të krijonin një shtet të fortë centralist. Centralizimi në sytë e tyre ishte identike me panturqizmin. Këto tentativa në Shqipëri hasën në rezistencë të fortë.⁹¹

Vitet e Monarkisë së Dytë Kushtetuese ishin një periudhë terrori sa i përket historisë së shtypit. Katër gazetarë u vranë⁹², vrasësit nuk u kapën dhe u krijua një atmosferë e rëndë presioni. Kjo u organizua nga njerëz të shquar të Komitetit të Bashkimit dhe Përparimit. Këta njerëz që e futën vendin në një qorrsoak në vitet në vijim, i nisën aktet e tyre terroriste duke vranë gazetarë në mes të rrugës.⁹³ I pari ndër të vranët ishte shqiptari Hasan Fehmiu, kryeredaktor i gazetës *Serbesti*.⁹⁴ Vrasja e Hasan Fehmi Beut si ngjarje u botua në gazetën shqiptare “Bashkimi i Kombit”. Vrasja e tij interpretohet në këtë mënyrë: “*E kanë pushkatuar Hasan Fehmiun se në gazetën e tij ka mbrojtur ligjin e popullit shqiptar. Pas kësaj ata filluan të sulmojnë të gjithë shqiptarët që punonin për kombin e tyre*”. Në tubimin e mbajtur nga opozita gjatë varrimit mori pjesë edhe Klubi Shqiptar Bashkimi.⁹⁵ Sipas historiografisë turke, fakti që Hasan Fehmiu ishte shqiptar tregon se intelektualët shqiptarë në opozitë ishin të ndikuar nga tendencat e tyre nacionaliste në pikëpamjet e tyre politike.⁹⁶

⁹⁰ Halil İnalçık, *Türklük Müslümanlık ve Osmanlı Mirası*, İstanbul, 2017, 274.

⁹¹ Skënder Riza, “Roli i Shqiptarëve në Revolucionin Xhonturk të vitit 1908”, *Kosova*, Enti i Historisë së Kosovës, Prishtinë, 1974, 178.

⁹² Hasan Fehmi, Ahmet Samim, Zeki Bey, Hasan Tahsin.

⁹³ Hıfzı Topuz, *II. Mahmut'tan Holdinglere, Türk Basın Tarihi*, 87-88.

⁹⁴ Për Jetën dhe Veprën e Hasan Fehmiut shih: Hıfzı Topuz, *Özgürlüğe Kurşun*, İstanbul, 2007. Faqe 11-45.

Hasan Fehmi Demir, *II. Meşrutiyet Dönemi'nde Serbesti gazetesi ve başyazarı Hasan Fehmi'nin misyonu*, Marmara Üniversitesi, Türkiyat Araştırmaları Enstitüsü, Teza e Masterit, İstanbul, 2018.

⁹⁵ Banu İşlet Sönmez, *II. Meşrutiyette Arnavut Muhalefeti*, 131.

⁹⁶ İhsan Burak Birecikli, *Arnavutlar ve Arnavutluk Sorunu*, 216-217; Banu İşlet Sönmez, *II. Meşrutiyette Arnavut Muhalefeti*, 131.

**THE ALBANIAN PRESS IN THE SECOND
CONSTITUTIONAL ERA AND THE ATTITUDE
OF THE HIGH PORTA TOWARDS IT**

Summary

The first examples of the Albanian press can be found in the second half of the 19th century. In addition, newspapers and magazines published by Albanians abroad ensured the development of the Albanian press. The activities of the press had an undeniable importance in the development of Albanian nationalism. It cannot be said that harsh measures were taken by the Ottoman governments against the Albanian press until the end of the 19th century and the beginning of the 20th century. In the magazines and newspapers published before 1908, there were publications against the absolutism of Sultan Abdylhamit II, as well as opinions about the Albanian language, history and the main problems of Albania. Also, information was given about the various activities of Albanian intellectuals, congresses, gatherings, conferences and efforts to create a society.

With the announcement of the Second Constitutional Monarchy, there was a revival in the world of the printing press and some press bodies entered into close relations with Albanian associations and ensured the spread of nationalist ideas. With the initiative of Albanian societies between 1908-1912, a total of 35 Albanian newspapers were published in Turkey and abroad. These newspapers declared that they would do journalism for the development of national culture within the framework of the rights and limits defined in the constitution. Between the years 1908-1912, newspapers reflecting the problems and important events of the national movement for the public played an important role in publishing their national thoughts and defending the political program of this movement.

As a result of the regulations imposed by the press law, newspapers in Albania were closed and newspaper writers were arrested. Fehim Zavalani, the editor of the newspaper *Bashkimi i Kombit* in Bitola, was arrested in September 1910 for publishing an article showing

the actions of the Ottoman army in Northern Albania and was sentenced to imprisonment and a fine of fifty lira. Even Lef Nosi, who ran the *Tomori* newspaper in Elbasan, was prosecuted by the Ottoman authorities for publishing articles that incited the Albanian people to revolt against the Committee of Union and Progress. Also, many newspapers that were published abroad were banned from entering the Ottoman territories.

BIBLIOGRAFIA

1. Burimet Arkivore

Türkiye Cumhuriyeti Cumhurbaşkanlığı Devlet Arşivi Başkanlığı
Osmanlı Arşivi (BOA)

BOA. BEO. 3786/283908.

BOA. BEO. 3802/285098.

BOA, BEO, 3815/286098.

BOA. BEO. 3806/285382.

BOA. DH.MKT. 553/11.

BOA. HR.SYS. 118/33.

BOA. HR.SYS. 119/14.

BOA. HR.SYS. D. 155/21.

BOA. MTZ (04). 119/54.

BOA. TFR.I.KV. 196/19595.

BOA. Y.A.HUS. 391/46.

BOA. Y.A.HUS. 505/43.

BOA. Y.MTV. 35/100.

BOA. ZB. 24/95.

MF. MKT. D. 1149/65.

BOA. DH.SYS. 59/9.

BOA. I.HB. 59/13.
BOA. DH.EUM.THR. 34/15.
BOA. MV. 140/15.
BOA. MV. 151/39.
BOA. DH.EUM.KADL. 16/31.
BOA. MV. 138/32.
BOA. DH.SYS. 68/1.
BOA. MV. 136/3.
BOA. HR.SYS. 67/45.
BOA. HR.HMŞ.İŞO. 234/4.
BOA. HR.SYS. D. 137/6.
Arkivi Qendror Shtetëror Shqiptar (AQSH)
AQSH. F. 65. D. 69.

2. Gazetat

Arnavut (Shqiptari), E Enjte 31 Shenendre 1909.
Arnavud, Nu: 22, 23 Haziran 1910.
Arnavud, Nu: 23, 6 Temmuz 1910.
Başkimi, 30 Tetor dhe 4 Nëntor 1910.
Bashkimi i Kombit, 17 Shtator 1910.
Besa, 5 Vjesht e tret 1908,
Dielli, 29 April, 1910.

3. Literatura Historiografike

Ahmad, Feroz, *İttihat ve Terakki 1908-1914*, İstanbul, 2016.
Arifi-Bakalli, Emine, *Përballje Historiografike*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2015.

Arslan, İsmail, *Balkan Savaşlarının 100. Yılı Anısına, Elveda Rumeli Merhaba Rumeli*, İstanbul, 2013.

Avdiu, Shpend, *Gazeta "Daşamiri"- "Daşamiri i Ri" 1907-1908*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2021.

Birecikli, İhsan Burak , *Arnavutlar ve Arnavutluk Sorunu 1908-1914*, Gazi Üniversitesi Sosyal Bilimler Enstitüsü, Teza e Doktoratës, Ankara, 2010, s. 205.

Boriçi, Hamit, *Gazetarë dhe Publicistë Shqiptarë, Fjalor Enciklopedik*, Botime UGPV, Shkodër, 2005.

Clayer, Natalie, *Arnavut Milliyetçiliğinin Kökenleri Avrupa'da Çoğunluğu Müslüman Bir Ulusun Doğuşu*, Çev.: Ali Berktaş, İstanbul, 2013.

Çelik, Bilgin, *İttihatçılar ve Arnavutlar*, Büke Kitapları, İstanbul, 2004.

Demir, Fehmi Hasan, *II. Meşrutiyet Dönemi'nde Serbesti gazetesi ve başyazarı Hasan Fehmi'nin misyonu*, Marmara Üniversitesi, Türkiyat Araştırmaları Enstitüsü , Teza e Masterit, İstanbul, 2018.

Elsie, Robert, *Histori e Lëtërsisë Shqiptare*, Tiranë, 1997.

Elsie, Robert, *History of Albanian Literature*, London: İ.B.Tauris, 2005.

Hanioğlu M. Şükrü, "İbrahim Temo (1865-1945) İttihat ve Terakkî Cemiyeti kurucularından Osmanlı siyaset adamı", *Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi*, Cilt 21, 354-355.

İbrâhim Temo, *İttihad ve Terakki Cemiyetinin Teşekkülü ve Hidematı Vataniye ve İnkılâbı Millîye Dair Hatıratım*, Mecidiye/Romanya 1939.

İnalçık, Halil, *Türklük Müslümanlık ve Osmanlı Mirası*, İstanbul, 2017.

Kaleshi, Hasan, "Disa aspekte të luftës për alfabetin shqip në Stamboll", Në: *Gjurmime Albanologjike*, 1, Prishtinë, 1969.

Kocabaşoğlu, Uygur "Hürriyet"i Beklerken, *İkinci Meşrutiyet Basını*, İstanbul, 2010.

Koloğlu Orhan, *1908 Basın Patlaması*, Baş-Haş, İstanbul, 2005.

Koloğlu, Orhan, *Osmanlı'dan 21. Yüzyıla Basın Tarihi*, İstanbul, 2006.

Kondo, Ahmet, *Flamuri i Arbrit: Çështja kombëtare*, Tiranë, Naim Frashëri, 1967.

Olgun, Said, *XIX. Yüzyılın İkinci Yarısında Arnavut Milliyetçiliğinin Gelişiminde Mektepler*, Fırat Üniversitesi Sosyal Bilimler Enstitüsü, Teza e Doktoratës, Elâzığ, 2015.

Olgun, Said, “Bir Jön Türk ve Arnavut Milliyetçisi: Derviş Hima (1872-1928)”, *Journal of History Studies*, 2018.

Ortaylı, İlber, *İmparatorluğun En uzun Yüzyılı*, İstanbul, 2001.

Prifti, Kristaq, *Dervish Hima (1872-1928)*, Tirane, 1987.

Prifti, Kristaq, *Doktor İbrahim Temo: Jeta dhe Vepra 1865-1945*, Prishtine, 1996.

Prifti, Kristaq, , “Kontributi i Shqiptarëve në Lëvizjen e Turqve të Rinj (1889-1908)” Në: *Gjurmime Albanologjike Seria E shkencave Historike 31-32*, 2001-2002, Prishtinë, 2003.

Reso, Zihni, *Anastas Kullurioti dhe gazeta “Zëri i Shqipërisë”*, 1879-1880, 8 nëntori, Tiranë, 1981.

Rizaj, Skënder, “Roli i Shqiptarëve në Revolucionin Xhonturk të vitit 1908”, *Kosova, Enti i Historisë së Kosovës*, Prishtinë, 1974.

Sönmez, İşlet Banu, *II. Meşrutiyette Arnavut Muhalefeti*, İstanbul 2007.

Topuz, Hıfzı, *Özgürlüğe Kurşun*, İstanbul, 2007.

Topuz, Hıfzı, *II. Mahmut'tan Holdinglere, Türk Basın Tarihi*, İstanbul, 2016.

Ünlü, Mucize, *Kosova Vilayeti (1877-1912)*, Ankara, 2014.